



Gjatë vitit akademik 2014 – 2015 nga komisioni i vlerësimit pranë Drejtorive Arsimore Rajonale janë identifikuar gjithësej **659** fëmijë me aftësi të kufizuara, të cilët ndjekin shkollën në **7** rajonet ku implementohet projekti i Save the Children “Gjithëpërfshirje për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore në Shqipëri” i financuar nga Koperacioni Italian i Zhvillimit/Ministria e Jashtme Italiane AID 010155/STC/ALB dhe zbatuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Shoqata MEDPAK i cili përfshin **14** shkolla dhe **14** kopshte në Peshkopi, Burrel, Durrës, Elbasan, Vlorë, Gjirokastrë dhe Korçë.

Nga këta 659 fëmijë janë vlerësuar nga Komisionet Shumëdisiplinare vetëm **98 fëmijë ose 15%!!!**



Gjithësej 61 fëmijë me aftësi të kufizuara janë nxënës të shkollave të projektit që Save the Children mbështet përmes programeve të tij multidisciplinare dhe gjithëpërfshirëse. Gjatë vitit akademik 2014 -2015, 45 fëmijë të cilët ndjekin shkollimin e tyre në shkollat ku Save the Children ofron mbështetje janë referuar për rivlerësim në Komisionet Shumëdisiplinare pranë Drejtorive Arsimore Rajonale.

Nga **45** fëmijë të referuar nga shkollat e projektit vetëm **13 fëmijë** janë vlerësuar nga Komisionet Shumëdisiplinare pranë Drejtorive Arsimore Rajonale; vetëm **30%** e tyre!



Akoma **598** fëmijë të tjerë me aftësi të kufizuara kanë nevojë për mbështetje cilësore në institucionet edukuese ku ata ndjekin shkollimin e tyre, të cilëve po u jepet një mbështetje sporadike nga mësuesit e patrajnuar në shërbim mbi gjithëpërfshirjen dhe menaxhimin e fëmijëve më aftësi të kufizuara në klasa dhe përmes psikologëve të cilët janë prezent vetëm një herë në javë në një shkollë.



Sipas informacionit të disponuar nga Komisionet Rajonale ekziston një numër i lartë i fëmijëve të cilët nuk janë vlerësuar akoma nga një Komision Shumëdisiplinar. Këta fëmijë nuk disponojnë asnjë dokumentacion (vlerësim mjeko-ligjor) dhe si rrjedhojë nuk marrin asnjë shërbim të bazuar në nevojat e tyre individuale.



Numri i ulët i vlerësimeve të kryera nga Komisionet Shumëdisiplinare pranë Drejtorive Arsimore Rajonale është rezultat i mungesës së instrumenteve prezente për vlerësimin e nevojave arsimore të fëmijëve dhe aq më tepër vështirësi në vlerësimin e fëmijëve të cilët nuk disponojnë një vlerësim mjeko-ligjor (fëmijët me aftësi të kufizuara).



Komisionet Shumëdisiplinare nuk janë trajnuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit mbi “Klasifikimin Ndërkombëtar të Funkcionalitetit”- Instrumenti i cili sipas dispozitës normative duhet të përdoret nga Komisionet Shumëdisiplinare në klasifikimin e nevojave arsimore të




Edhe pas trajnimeve të ofruara nga Save the Children mbi implementimin e instrumentit të “Klasifikimit Ndërkombëtar të Funkcionalitetit”, Komisionet Shumëdisiplinare hasin pengesa të tjera në vlerësimin e fëmijëve bazuar në këtë instrument si psh mungesa e punonjësit psikosocial dhe mjekut pediatër të cilët janë pjesëtarë të domosdoshëm të ketyre komisioneve.




Edhe pse kadri ligjor nuk mungon, për mirëfunksionimin e Komisionet Shumëdisiplinare, është e nevojshme që Ministria e Arsimit dhe Sportit të hartojë një rregullore të funksioneve të pjesëmarrësve në Komisionet Shumëdisiplinare të cilat të përcaktojnë përkrahimin e pozicionit me terma të fiksuara kohore e cila përcakton edhe shpërblimin e tyre për ofrimin e shërbimit pranë Komisioneve Shumëdisiplinare.

Vështrim mbi Komisionet Shumëdisiplinare në Arsim në 7 Rajone (2014-2015)


Numri total i fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat/ kopshte e rajoneve



Vlerësimet e Komisionet Shumëdisiplinare pranë Drejtorive Arsimore Rajonale për periudhën 2014-2015



Numri i mësuesve mbështetës në total për rajonin



Numri i fëmijëve që mbështetet nga Save the Children (2 shkolla, 2 kopshte në çdo rajon)

